



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit

Nr. 04-610/01-15173/25

Datë, 02.07.2025

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për Regjistrimin e Nxënësve në Klasën e Dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor **2025/2026**

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazëve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor **2025/26**, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve:

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnaz dhe IAAP për vitin shkollor 2025/2026, bëhet më datën **08, 09 dhe 10 korrik 2025**, në lokalit e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **11.07.2025**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **11 korrik 2025**. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHTI-t Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | | |
|---|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%) 100 pikë.

Shih: Njoftimin Nr. 3/2497 e MASHTI-t të datës 01.07.2025, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2025-2026.

IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
1.	Makineri, Prodhim, Ndërtimtari dhe Elektronikë	- Operator Prodhimi	1	24
		- Instalues elektrik	1	24
		- Automekanik (mësim DUAL)	1	24
		- Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit	2	48
		- Trafik rrugor	1	24
2.	EKONOMI	- Marketing dhe Shitje	1	32
		- Tregu me shumicë dhe pakicë (mësim DUAL)	1	32
		- Kontabilitet dhe tatime	1	32
3.	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	- Informatikë	1	32
4.		Gjithsej	10	272

Gjimnazi "Skënderbeu" - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve	
1.	Shkenca Natyrore	Shkenca Natyrore	4	128
2.	Shkenca Shogërore- Gjuhësore	Shkenca Shogërore- Gjuhësore	3	96
	Gjithsej	2	7	224

Drejtori DKA-së
z. Zahir Boda

